



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjilan
Gilan Belediyesi

Bazuar në nenin 37, paragrafi 1.8 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01.Nr.016-126211 të datës 06.11.2014, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Arsim, 01.Nr.225/2016 dt. 15.11.2016, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, 01.Nr.231/2016 të datës 22.11.2016 Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur me 29.11.2016 miraton këtë:

VENDIM

PER MIRATIMIN E PLANIT TE VEPRIMIT PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE DHE PËRFORMANCËS NË EDUKIMIN PARASHKOLLOR NË KOMUNËN E GJILANIT 2015-2017

1. Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Gjilanit miraton Planin e veprimit për përmirësimin e shërbimeve dhe përfomancës në edukimin parashkollor në Komunën e Gjilanit 2015-2017
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është: Vendim për miratimin e Planit të veprimit për përmirësimin e shërbimeve dhe përfomancës në edukimin parashkollor në Komunën e Gjilanit 2015-2017 i hartuar grupit punues për hartimin e Planit të Veprimit për Përmirësim të shërbimit të edukimit parashkollor në territorin e Komunës së Gjilanit e i përkrahur nga gjithë drejtorët dhe personeli i IEA–ve, Drejtoria për Urbanizëm e Drejtoria e Administratës, ndërsa në veçanti USAID-i përmes përfaqësuesve të programit AKT të cilët ndihmuan grupin si me trajnime ashtu edhe me asistencë në përdorimin e një metodologjie të re e cila bazohet në menaxhimin e performancës për përmirësim të shërbimeve.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i KK-Gjilan dhe Drejtoria e Arsimit, ndërsa për implementimin e tij kujdeset Kryesuesi i KK-Gjilan.
4. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb fagen e Komunës.

01.Nr. 016-117683
Gjilan, më 29.11.2016

Kryesuesja e Kuvendit
Valentina Bunjaku-Rexhepi,